



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.386/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 07.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.386/2025, Anr.391/2025, Anr.396/2025, të datës;05.02.2025, të ushtruara kundër koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë;04.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.386/2025, Anr.391/2025, Anr.396/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA, me seli në Prishtinë.

Në ankesën Anr.386/2025, Pretendohet se me 2 Shkurt 2025, në tubimin zgjedhor të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme AAK), kandidati për deputet i këtij subjekti, Agron Kuqi, në fjalimin e tij ka përdorur gjuhë deniguresse dhe fyese me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit Albin Kurti, duke cenuar rëndë nenin 34. Pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Agron Kuçi, me qëllim të etiketimit dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit Albin Kurti dhe me qëllim të promovimit të subjektit të tij politik i është drejtuar një mase të gjerë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse si: z. Kurti para një jave, i cili duke thurr elozhe për bukuritë e Junikut, nuk u tregoi bashkëpartiakëve të tij që është në përpjekje të suprimimit të komunës së lunikut... ”atdheut tonë te dashur nuk i duhet një kryeministër pa shpi e pa katandi, pa shtet e atdhedashuri... si pasojë e një qeverie të keqe dhe autokratike...”.

Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkangjitur: Linku i tubimit zgjedhor të publikuar në facebook në kundërshtim me LZP nga min 15:00 dhe pjesët e shkëputura nga fjalimi <https://www.facebook.com/RamusharadinajOfficial/videos/1308420310354136/>

Në ankesën Anr.391/2025, pretendohet se Më 04.02.2025 kandidati për deputet i koalicionit AAK-Nisma, z.Gani Bajraktari në Ilogarinë personale të platformës Facebook ka shpërdarë shkrim me përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj Kryeministrit Kurti me këtë përmbajtje:Kryeministri aktual Albin Kurti,JEP DEKLARATA FALSE (të pavërteta),• MOS U MASHTRONI!Qeveria e tij është e pabesueshme për Administratat TRUMP dhe BIDEN!Krejt komuniteti ndërkombëtar është KUNDER KURTIT1,kështu nuk po them unë,KËSHTU PO THOTË RICHARD GRESELL, një ndër personat më të afërt dhe më të rëndësishëm të Presidentit aktual të SHBA, TRUMP!A është vështirë për ta kuptuar se në çfarë pozite mund të gjindet Kosova nëse ne nuk jemi të vëmendshëm. Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkangjitur CD nga fotodokumentacioni.

Në ankesën Anr.396/2025 pretendohet se Më 04.02.2025 kandidati për deputet i koalicionit AAK-Nisma, z.Fatmir Limaj gjatë takimeve me pronarët dhe punëtorët e bizneseve në funksion të fushatës elektorale për Zgjedhjet Parlamentare të datës 09.02.2024. për qëllime politike ka bërë deklaramë fyese dhe shpifëse në drejtim të Qeverisë së Republikës së Kosovës si në vijim"tash e 4 vite Kosova është në garë të mashtrimit, shpifjes dhe gënjeshtërisë për t'iu a bërë jetën më të vështirë jetën qytetarit të Kosovës fatkeqësisht edhe juve"... Në po të njëjtin takim z.Fatmir Limaj ka dhënë deklarata shpifëse ndaj Qeverisë së Republikës dhe Lëvizjes Vetëvendosje duke propaganduar se ; "Përball keni një politikë e Cila po thotë kështu: Ushtarët e UÇK-së janë të mirë të vdekur, cka është e gjallë është pengesë...".Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkangjitur : 2 CD nga videodeklarimi.

Në përgjigjen në ankesa të koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK-NISMA theksohet si në vijim: Në përgjigjen për ankesën Anr.386/2025 të datës 06.01.2025, Koalicioni AAK-NISMA, vlerëson se pretendimi kinse z.Kuçi, qeverisjen e z.Kurti e ka quajtur autokratik dhe qeveri të keqe,përveç se është i mangët në përshkrimin faktik, i njëjti ka tendencë për të cenuar sigurinë juridike në përgjithësi e demokracinë e vendit në

veçanti. Në rastin e deklaratës së z. Kuçi, nuk ka asnjë indicie që fjalët e përdorura kanë pasur qëllimin për të nxitur dhunë ose diskriminim.

Në përgjigjen në ankesën Anr.391/2025 theksohet se lidhur me pretendimin se kinse Gani Bajraktari, për z. Kurti ka deklaruar se i njëjti jep deklaratë false, dhe i njëjti është i pabesueshëm për administratën Trump dhe Biden, duke vazhduar të thotë se këtë konstatim e bën Richard Grenell, pra pikërisht, z. Bajraktari ka bërë transmetim të qëndrimeve të emisarit special z. Grenell i cili e ka quajtur z. Kurti jo të besueshëm në raport me Amerikën, duke marrë parasysh se z. Grenell është i emruar special i z. Trump (Presidentit Amerikan) ka konstatuar se ky qëndrim nuk është konkluzion i tij personal, por qëndrim i pushtetit qeverisës Amerikan. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë po ashtu ka theksuar se deklaratat e z. Bajraktari nuk kanë për qëllim të nxjerrin dhunë apo urrejtje ndaj individëve ose grupeve, ato janë thjesht një shprehje e një mendimi mbi veprimet e qeverisë duke u bazuar në deklaratat e funksionarëve Amerikan, pa sugjeruar ndonjë formë të veprimit të dhunshëm ose shoqëror. Parashtruesi i përgjigjes si provë ka bashkangjitur: <https://aheës.com/rajoni-bota/kosova/politike/grenell-godet-kurtin-partner-joi-besueshëm-ndërkombëtar-i-1138497>.

Në kërkesën për përgjigjen për ankesën Anr.396/2025, koalicioni AAK-nisma nuk ka dhënë ndonjë përgjigje.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.386/2025, A.nr.391/2025, Anr.396/2025 të paraqitura me datë 05.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.386/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër koalicionit AAK-NISMA, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Bazuar në të lartcekurat paneli ka gjetur ankesat janë të pabazuara

Për faktin se pas shikimit të video incizimit të ofruara si prova materiale nga ankuesi, shihet kandidati për deputet i këtij subjekti, Agron Kuqi, në fjalimin e tij gjatë tubimit elektorale është drejtuar një mase duke përdorur fjale me kete përmbajtje: *Kurti para një jave, i cili duke thurë elozhe për bukuritë e Junikut, nuk u tregoi bashkëpartiakeve të' tij që është në përpjekje të suprimimit të komunës së Junikut... "atdheut tonë të dashur nuk i duhet një kryeministër pa shpi e pa katandi, pa shtet e atdhedashuri... si pasojë e një qeverie të keqe dhe autokratike..."*. andaj sipas vlerësimit të panelit deklarimi i tillë, nuk mund të quhet gjuhë denigruese apo gjuhë urrejtuese, nuk nxit ndonjë person të kryej ndonjë akt të dhunës dhe nuk cenon nenin 34. Pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.”,

Po ashtu Paneli duke analizuar fjalimin e kandidatit për deputet i koalicionit AAK-Nisma, z. Gani Bajraktari i cili në Ilogarinë personale të rrjetit social Facebook ka shpërdarë shkrimin

ndaj Kryeministrit Kurti me këtë përmbajtje:”Kryeministri aktual Albin Kurti,jep deklarata false (të pavërteta), mos u mashtroni, Qeveria e tij është e pabesueshme për Administratat Trump dhe Binden Krejt komuniteti ndërkombëtar është kundër Kurtit 1, kështu nuk po them unë,kështu po thotë Richard Grenell, një ndër personat më të afërt dhe më të rëndësishëm të Presidentit aktual të SHBA, Trump, A është vështirë për ta kuptuar se në çfarë pozite mund të gjindet Kosova nëse ne nuk jemi të vëmendshëm, Kështu qe sipas vleresimit te panelit deklarimi I tille,eshte nje paraqitje e nje pikepamje individuale te kandidatit, nuk shfaqe urrejtje dhe nuk mund te quhet nxitese andaj nuk bie ne kundershtim me nenin 34. Pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.”,

Deklarimit i kandidati për deputet i kualicionit AAK-Nisma, Fatmir Limaj gjatë takimeve me pronarët dhe punëtorët e bizneseve në funksion të fushatës elektorale, të datës 09.02.2024, është shprehur si në vijim "tash e 4 vite Kosova është në garë të mashtrimit, shpifjes dhe gënjeshtërs për tua bërë jetën më të vështirë jetën qytetarit të Kosovës fatkeqësisht edhe juve"... si dhe deklarimin; "Përball keni një politikë e cila po thotë kështu: Ushtarët e UÇK-së janë me të mirë të vdekur, cka është e gjallë është pengesë...".

Dhe duke i vlerësuar këto deklarime të kandidatit Fatmir Limaj, Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Fjalimet e tilla të përdorura nga kandidatët e koalicionit AAK-NISMA konsiderohen se hyjnë në diskursin e fushatës zgjedhore, dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë,

Andaj paneli vlerëson se deklarimet e lartcekura nga ana e kandidateve nuk konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.386/2025, datë 07.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.